



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA DIBËR

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. prot
me: ____ .12.2019

Peshkopi,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: “SELAMI“ sh.p.k, me nr nipti **J77304706L**, me adrese: Diber Peshkopi Lagjja "Nazmi Rushiti, "Rruga "Tercilio Kardinali", kati i dytë ndërtesa e quajtur "VERI" PESHKOPI.

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Ndërtim i Shkolles 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër, me Nr. REF-36793-09-23-2019.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Date 30.09.2019] [Nr. 39]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- **Nipti:** J76418903B **Emri i Subjektit:** "LALA" **Objekti i Aktivitetit:** Grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbejtjeve te llojeve te ndryshme urbane. Import - eksport, tregti te mallrave te ndryshem, transport mallrash e pasagjeresh etj. Germime dheu me punime eventuale murature e beton armeje, sistemime,.....**I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 40.952.311 (Dyzet milion e nenteqind e pesedhjetë e dy mijë e treqind e njemdhjetë) leke pa TVSH.**
- **Nipti:** K02017003I **Emri i Subjektit:** AURORA **KONSTRUKSION Objekti i Aktivitetit:** Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhim, montim te cdo lloj qofshin civile, industriale apo bujqeosre, ndertim linja elektrike, hidraulike, ujesjellesa, kanalizime, rruge, prita, ura, tunele, vepra arti e restaurime. Ne fushen e studimit, projektim....**I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 37.780.003 (Tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e tre) leke pa TVSH.**

- **Nipti:** K71412003A **Emri i Subjektit:** BE-IS SH.P.K **Objekti i Aktivitetit:** Studim - Projektim, Konsulenca te ndryshme. Ndertime konstruksione te ndryshme. Prodhime, perpunime materiale inerte, perpunim, prodhim lende drusore, alumini dhe hekuri, import eksport i tyre. Hapje kurse private te formimit profesional, punime hid...***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 38.260.509(Tridhjetë e tete milion e dyqind e gjashtedhjetë mijë e pesëqind e nente) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** J82916489E **Emri i Subjektit:** COLOMBO **Objekti i Aktivitetit:** Punime gërmim ne toke, ndertime civile dhe industrial, rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile dhe industrial veshje fasada, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramway, metro, psta aeroportuale, punime nentokesore, ura e vepra arti, dig...***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 37.365.060 (Tridhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtedhjetë e pesë mijë e gjashtedhjetë) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** J67902718S **Emri i Subjektit:** CURRI **Objekti i Aktivitetit:** Ndertimi, projektim dhe zbatim, projektim e ndertim te objekteve te ndryshem civile, industriale, turistike, bujqesore etj, restaurime te godinave e objekteve te ndryshme private, social-kulturore, te kultit etj, punime dheu e transport, punime murat...***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 41.408.152 (Dyzetë e një milion e katerqind e tete mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** J96829419D **Emri i Subjektit:** EGLAND **Objekti i Aktivitetit:** Ne fushen e projekteve e te ndertimit te veprave te ndryshme te infrastruktures.Ndërtime e mirëmbajtje rrugësh dhe linjash hekurudhore.Ndërtime civile dhe rikonstruksione.Ndërtime ujësjellsash dhe kanalizime. Objekte industriale, bujqesore, social ...***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 41.973.791 (Dyzetë e një milion e nentëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nentëdhjetë e një) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K67106202W **Emri i Subjektit:** ELDA-VL **Objekti i Aktivitetit:** Kryerjen e punimeve te ndertimit, ushtrimin e aktivitetit ne fushen e ndertimeve publike ,ndertime civile , pallate , rruge , ura , ujesjellesa,kanalizime , pastrim gjelberime. Import eksport, tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshe... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 0 (zero) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K31929010K **Emri i Subjektit:** EUROGJICI-SECURITY **Objekti i Aktivitetit:** Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike", i cili ushtrohet ne te gjithë territorin e vendit dhe jashte tij (me punonjes sherbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, ...***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 0 (zero) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** J91815014U **Emri i Subjektit:** GJOKA **KONSTRUKSION Objekti i Aktivitetit:** Projektimi dhe ndertimet te karaktereve te llojeve te ndryshme sipas licensave te ndryshme me te cilat shoqeri eshte pajisur dhe do te pajiset ne te ardhmen, prodhimi i materialeve te ndertimit, inerteve, betonit te markave te ndryshme, te parafabrik.. ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 44.422.568 (Dyzetë e kater milion e katerqind e njetzet e dy mijë e pesëqind e gjashtedhjetë e tete) leke pa TVSH.***

- **Nipti:** K51712017A **Emri i Subjektit:** K A C D E D J A **Objekti i Aktivitetit:** Ndertime civile, Import, eksport, tregtim i artikujve te ndryshem industriale, ushqimor, blegtoral, agjenci imobiliare, turistike, transport mallrash te te gjitha llojeve, tregtim bimesh medicinale e etero vajore. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobi... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 36.597.981 (Tridhjete e gjashte milion e peseqind e nentedhjete e shtate mije e nenteqind e tetedhjete e nje) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K71401004W **Emri i Subjektit:** KEVIN KONSTRUKSION **Objekti i Aktivitetit:** Vepimtari ne fushen e ndertimit privat dhe publik; germime dhe; prodhime materiale inerte-gure; prodhim elemente betoni e beton arme te zakonshme; ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore. Rikonstruksione; ndertim banesa me skela mbi 8 kate; nderti... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 32.068.615 (Tridhjete e dy milion e gjashtedhjete e tete mije e gjashteqind e pesembedhjete) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K31329048I **Emri i Subjektit:** NDREGJONI **Objekti i Aktivitetit:** Investitor ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme civile dhe industriale, private dhe shteterore, social kulturore dhe agjensi per shitblerjen e ketyre ndertimeve. Ndertimi, rikonstruksioni dhe mirembajtja e tyre e punimeve germimi ne toke, ... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 36.167.314 (Tridhjete e gjashte milion e njeqind e gjashtedhjete e shtate mije e treqind e katermbedhjete) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K51501008J **Emri i Subjektit:** S I R E T A 2F **Objekti i Aktivitetit:** Ne fushen e ndertimit, import eksport i mallrave ushqimore e industriale dhe makinerive te ndertimit, autoveturave, tregti me shumice e pakice, sherbime riparime, perpunim druri, melamin, duralumin, servisautomjetesh, lavazh. Riparimin, grumbullimin, perpunimi... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 39.087.055 (Tridhjete e nente milion e tetedhjete e shtate mije e pesedhjete e pese) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** J77304706L **Emri i Subjektit:** SELAMI **Objekti i Aktivitetit:** Linje prodhimi inertesh, linje asfalto betoni, bar-bufe-restaurant-hotel. Nderitim dhe rikonstruksion ndërtesash, punime infrastrukturë si: ujësjellsa, kanalizimerrugë, impiante të trajtimit dhe pastrimit, tregtim të materialeve të ndërimit, import-eksp... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 42.977.386 (Dyzet e dy milion e nenteqind e shtatedhjete e shtate mije e treqind e tetedhjete e gjashte) leke pa TVSH.***
- **Nipti:** K07924803N **Emri i Subjektit:** Shendelli **Objekti i Aktivitetit:** Ndertimit, studimit, projektimit, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, rikonstruksione, vepra betonarmeje te vecanta portuale, rrugore, hekurudhore e aeroportuale, vepra arti rrugore, hekurudhore, hidraulike, tunele te impianteve te prod... ***I cili ka paraqitur oferten ekonomike me vlere 38.782.300 (Tridhjete e tete milion e shtateqind e tetedhjete e dy mije e treqind) leke pa TVSH.***

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1-Operatori ekonomik: “LALA” shpk, me Nipti: J76418903B, *me oferte ekonomike me vlere 40.952.311 (Dyzet milion e nenteqind e pesedhjete e dy mije e treqind e njembedhjete) leke pa TVSH.*

Per arsyet:

- Ne permbushje te pikes 2.2.1, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur kontratat per “**Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën**”: *Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë prej jo më pak se 50 % te fondit limit ose Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën një vlerë prej 200 % të fondit limit, me objekt: “Ndertim Ujesjellesi I fshatrave Vranisht, Fajza, Liqeni Kuq”, “Rikonstruksion ujesjellsi fshati Krume dhe Zahrisht, punime shtese”, si dhe “Rehabilitim I linjes se furnizimit me uje dhe kanalizimeve te qytetit te Sarandes”. Gjate analizimit te zerave te preventivave pje e kontratave te paraqitura nga ana juaj, ne permbushje te pikes 2.2.1, Kapaciteti Teknik te DST, theksojme qe asnjera nga kontratat nuk eshte e ngjashme perkundrazi rezultojne te nje natyre krejtesisht te ndryshme me preventivin e punimeve te ngarkuar ne SPE nga AK Bshkia Diber per proceduren me objekt: “Ndërtim i Shkolles 9-vjeçare, Fshati Kërçisht, Bashkia Dibër”, 2019.*
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur, ju keni paraqitur dokumentacionin Kontrate Qeraje nr. 3927 rep. 1116 kol. date 13.07.2019 per mjetet **skeleri**, ku rezulton se nuk eshte ne perputhje me kerkesen e AK ne dokumentat standarte te tenderit, perkatesisht pika 2.2.7 ku citohet: *Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (original ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerase duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti***, pasi nuk eshte cituar objekti I prokurimit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur, ju keni paraqitur dokumentacionin lidhur me mjetet ne pronesi te subjektit BIBA-X, ku pas shqyrtimit te dokumentacionit ne fjale, rezulton se nuk eshte dorezuar ne sistemin e prokurimeve elektronike, kontrata qerase per asnjerin nga mjetet ne pronesi te OE BIBA-X te pretenduara nga ana juaj si te marra me qera per e realizimin e objektit te prokurimit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur, ju keni paraqitur dokumentacionin Kontate Qeraje per mjetet lidhur me subjektet: Alfred Cuka, Vllazerimi, dhe Loti sh.p.k ku rezulton se kontratat e nenshkruara per marrjen me qera te mjeteve nuk jane ne perputhje me kerkesen e AK ne dokumentat standarte te tenderit, perkatesisht pika 2.2.7 ku citohet: *Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (original ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerase duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti***, pasi ne to nuk eshte cituar objekti I prokurimit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur, nder te tjera ju keni paraqitur dokumentacionin,

kontrate qeraje per mjetet **Autobetoniere** me nr 3928 rep. 1117 kol date 13.07.2019 te lidhur me subjektin Vllaznimi sh.p.k por gjate shqyrtimit te dokumentacionit te te gjithë operatoreve ofertues ne proceduren e prokurimit, verejme se subjekti Vllaznimi shpk ka lidhur kontrate noteriale me nr. 1989 rep.650 kol date 30.09.2019, me subjektin Shendelli sh.p.k, ne analize te te cilave rezulton nder te tjera se mjetet Autobetoniere ne pronesi te OE VLLAZNIMI shpk jane dhene me qera per te dyja kontratat e qerese te siperpermendura gje e cila nenkupton fiktivitetin e kontratve te qerese ne fjale duke shtuar ketu se edhe periudha e ketyre kontratave krijon perplasje kohore me njera-tjetren. Si rrjedhoje OE LALA shpk nuk permbush kerkesen e AK ne dokumentat standarte te tenderit, Shtojca 10 “Deklarate te disponueshmerine e mjeteve/makinerive”

- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me mekanikun z. Robert Gaci, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale keni ngarkuar dokumentin *dilpome te shkolles se mesme te pergjithshme* dokument I cili nuk eshte ne permbushje te kerkes se AK.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur 3 diploma per punonjesit: Z. Bernar Bileri, Ilirjan Lala, dhe Oldinis Lala, ku sipas kontratave respektive te punes dhe ne IQT-ve rezulton se diplomat e sipercituara nuk jane ne permbushje te kerkes se AK pasi nuk pasqyrojne profesionin e punonjesve.

2- Operatori ekonomik: “AURORA KONSTRUKSION ” **shpk**, me Nr **Nipti: K02017003I**, ***me oferte ekonomike me vlere me vlere 37.780.003 (Tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e tre) leke pa TVSH.***

Per arsyet:

- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me elektrikistin z.Eduart Daci, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon dhe libreza e punes,dhe rezulton qe ne listpagesa nga muaji janar 2019 e deri ne shtator 2019 eshte paguar mesatarish me nga 4 dite pune per cdo muaj, gje e cila eshte ne kundërshtim me kontraten e punes, kriterit ne DST,mungon dhe libreza e punes per punonjesin ne fjale.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me elektrikistin z.Ferit Balliu, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon diploma.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit ne lidhje inxhinierin elektrik z.Gezim Malindi, pas verifikimit ne listpagesa rezulton qe nga muaji janar e deri ne shtator 2019 rezulton te jete paguar me nga 10 dite pune ne muaj gje e cila eshte ne kundërshtim me kontraten e punes dhe kriteret e DST,ku inxhinierat duhen detyrimisht figurojne detyrimisht ne

listpagesa me kohe te plote sipas kontrates se punes.

- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur kontraten e qerases nr 1587rep. 857 kol. per mjetin autovinc me targe AA206NJ, por gjate verifikimit te dokumentacionit per kete mjet rezulton qe nuk keni cituar objektin ne kete kontrate qeraje sic kerkohet ne DST ku citohet Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesis se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur te gjitha dokumentat per mjetin tip minieskavator me kontrate noteriale nr 3682 rep 1275 kol date 12.05.2018, por rezulton qe nuk keni cituar objektin sic kerkohet ne DST ku citohet Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesis se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.

3-Operatori ekonomik: “BE-IS ”, me Nipti: K71412003A me oferte ekonomike me vlere 38.260.509(Tridhjete e tete milion e dyqind e gjashtedhjete mije e peseqind e nente) leke pa TVSH.

Per arsyet:

- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni dorezuar ne SPE 3 (tre) kontrata qeraje perkatesisht me nr.1833 rep/719 kol date 22.02.2019 per mjetet me targe EL1401C,AA157D, , me nr 2142 rep/827 kol date 02.03.2019 per mjetin me targe TR6504J dhe kontrate qeraje me nr.5271rep/2871 kol per mjetin me targe SR7741B, **Kamion veteshkarkues (kapaciteti mbajtes 10-15 ton)**, ku rezulton se kontratat e nenshkruara per marrjen me qera te mjeteve nuk jane ne perputhje me kerkesen e AK ne dokumentat standarte te tenderit, perkatesisht pika 2.2.7 ku citohet: *Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesis se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti*, pasi ne to nuk eshte cituar objekti I prokurimit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju si operator ekonomik keni paraqitur dokumentacionin perkates te mjetit me targe AA095VO te tipit **Autobot** dhe kontraten e qerases me nr 2147 rep/832 kol date 02.03.2019, rezulton se ky mjet nuk eshte deklaruar nga ana juaj ne shtojcen nr.10 per disponimin e makinerive.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur kontrata qeraje me nr.1833 rep/719 kol date 22.02.2019 per mjetin me targe EL0128C per permbushjen e kriterit te kerkuar nga AK ne piken 2.2.7 **Autovinc** cope 2(dy), verejme qe ne kontraten e qerases nuk eshte cilesuar objekti, qe e cila eshte kerkuar ne DST ku citohet: Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesis se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te**

cilesohet objekti. Domethene qe ju nuk plotesoni kriterin prej dy mjeteve qe ja jane kerkuar ne DST pasi keni paraqitur dokumentacionin vetem per njerin mjet me targe AA356YJ.

- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur dokumentacionin perkates te mjetit me targe AA176NH, dhe kontrate qeraje me nr 8167 rep,5798 kol, date08.09.2018 permbushjen e kriterit te kerkuar nga AK ne piken 2.2.7 **Autobot uji** cope 1 (nje) verejme qe ne kontraten e qerase nuk eshte cilesuar objekti, qe e cila eshte kerkuar ne DST ku citohet: Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerase duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.** Gje e cila ju nuk permbushni kriterin e AK per mjetin ne fjale(Autobot)
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju skeni paraqitur dokumentacionin perkates te mjetet me targe AA406MA dhe AA890NF te tipit Autobetonjere me kontrate qeraje nr 6568 rep/2674 kol date18.07.2018 permbushjen e kriterit te kerkuar nga AK ne piken 2.2.7 **Autobetoniere Betoni** copë 2 (dy), verejme qe ne kontraten e qerase nuk eshte cilesuar objekti, qe e cila eshte kerkuar ne DST ku citohet: Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerase duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.** Gje e cila kontrata e qerase nuk ju nuk eshte ne perputhje me kerkesat e AK per mjetet ne fjale. (Autobetoniere).
- Pas verifikimit te dokumentacionit te teknikut te ndertimit z. Petrit Dema rezulton qe ka lidhur kontrate pune me shoqerine BE-IS shpk me date 31.05.2019, dhe pas verifikimit ne listpagesen e muajit maj 2019 rezulton qe eshte me 22 dite pune, gje e cila nuk korespondon me daten e lidhjes kontrates se punes.

4-Operatori ekonomik: “COLOMBO”, me Nipti: J82916489E **me oferte ekonomike me vlere 37.365.060 (Tridhjetë e shtatë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë) leke pa TVSH.**

Per arsyet:

- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me elektricistin z.Kastriot Brati, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon diploma.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me hidraulikun z.Endrit Lozeraj ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon diploma.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas verifikimit te dokumentacionit tuaj ne sistemin e prokurimeve publike elektronike per procedure ne fjale, na rezulton qe keni paraqitur

shtojcen 10 per disponimin e makinerive, dhe verejme qe keni paraqitur kontratat noteriale per mjetet si meposhte: nr.1677rep 1201 kol date 15.05.2018 per kamionin me targe AA983SK, nr 2050 rep 1489 kol date 16.12.2017 per mjetin me targe VL4863B, nr 1821 rep 1660/1 per mjetet me targe VL9884A,VL4533B, nr 1677 rep 1201 kol date 15.05.2018, nr.151 rep 66 kol date 11.01.2018 per mjetin me targe AA185GB, nr 4418 rep 3049/1 kol per mjetin me targe AA883HY, nr 1515 rep 1007 kol date 16.05.2017 per mjetin me targe VL7985C, nr 706 rep 528/2 kol date 20.02.2019 per mjetin tip minieskavator, nr 430 rep 328/1 kol per mjetet me targe AA089HS,AA120NA, nr 809 rep 602/1 kol, nr 2411 rep 1724 kol per mjetet me targe AA403,AFR185. Pas verifikimit te gjithë dokumentacionit te mjeteve dhe pajisjeve na rezulton qe asnjera nga kontratat e qerases te paraqitura nga ana juaj nuk eshte ne perputhje me kriteret e AK sipas DST dhe shtojces nr 1 date 21.10.2019 ne piken 2.2.7 ku citohet: Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesis se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.**

- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit,ju keni pasqyruar te gjithë mjetet e marra me qera per realizimin e kesaj procedure prokurimi ne shtojcen nr.10, kontratat e qerases si meposhte: nr.1821 rep 1660/kol, nr 4418 rep 3049/1 kol, nr 706 rep 528/2 kol, nr 430 rep 328/1 kol, nr 809 rep 602/1 kol, nr 2411 rep 1724 kol, rezulton qe shtojca 10 nuk eshte plotesuar sipas formularit standarte, sepse ne kolonen e fundit te shtojces 10 nuk eshte deklaruar data e fillimit dhe mbarimit e kontrates se qerases.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas verifikimit nga ana jone rezulton qe z.Kasrtiot Brati me profesion elektrikist ne muajin gusht 2019 rezulton me 13 dite pune, gje e cila eshte ne kundërshtim me kontraten e punes dhe me kriterin DST ne piken ku citohet: **te figuroje ne listpagesen e shoqerise, per periudhen Janar 2019 – deri ne daten e zhvillimit te tenderit.**
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas verifikimit te punonjesit me profesion elektrikist z.Endrit Lazeraj ne listpagesat e 2019 rezulton nga muaji janar 2019 e deri ne qershor 2019 eshte me nga 13 dite pune gje e cila nuk eshte ne perputhje kriteret e DST.dhe me kontraten e puneste punonjesit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas verifikimit te punonjesit me profesion mekanik z.Ediol Memsullaj ne listpagesat e vitit 2019 rezulton qe nga muaji janar 2019 e deri ne korrik 2019 eshte me nga 13 dite pune gje e cila nuk eshte ne perputhje kriteret e DST dhe kontraten e puns te punonjesit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas verifikimit te punonjesit me profesion teknik ndertimi zj.Drita Sinamati ne listpagesat e vitit 2019 rezulton nga muaji janar 2019 e deri ne qershor 2019 eshte me nga 13 dite pune gje e cila nuk eshte ne perputhje kriteret e DST dhe kontraten e punes te punonjesit.

5-Operatori ekonomik: "CURRI" , me Nipti: J67902718S *me oferte ekonomike me vlere 41.408.152 (Dyzete e nje milion e katerqind e tete mije e njeqind e pesedhete e dy) leke pa TVSH.*

Per arsyet:

- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me Ing. Gjeodet z. Hajri Domi, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon librezja e punes, dhe pas verifikimit ne listpagesave lidhur me Ing.Gjeodet z. Hajri Domi, rezulton se me date 22.04.2019 eshte lidhur kontrata mes personit dhe shoqerise CURRI shpk, dhe konstatojme se z.Hajri Domi nuk figuron ne listepagesen e muajit prill, maj 2019, si dhe ne muajin qershor, korrik rezulton me nga 12 dite pune, gje e cila eshte ne kundërshtim me kerkesen e AK sipas pikes 2.2.6 te DST dhe me kontraten e punes se nenshkruar nga dy palet ku citohet qe punonjesi do te kryeje 40 ore pune ne jave.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me Teknikun e ndertimit z, Ludovik Precetaj, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon librezja e punes.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me mekanikun z. Melsi Keçi, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale eshte konstatuar mungesa e diplomes, CV-se, librezes se punes si dhe IQT eshte e skaduar.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me Elektricitistin z. Arjan Kakarriqi, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale eshte konstatuar mungesa e librezes se punes, dhe CV-se.
- Ne shqyrtim te dokumetacionit Kontrate Qeraje, me nr 603 rep,103 kol. Date 10.11.2018 per mjetet te tipit Autobetoniere eshte konstatuar mungesa e aktit te pronesise, lidhur me mjetet me targa TR0748S, dhe TR1068N, si dhe nuk eshte i cituar ne kontraten e qerases objekti I prokurimit sipas kriterit te pikes 2.2.7 te DST-se ku citohet: *Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (original ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerases duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.***
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me hidraulikun, z. Sabah Frangaj ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale eshte konstatuar mungesa e CV-se, librezes se punes si dhe nuk rezulton i perfshire ne listpagesen e muajit shtator 2019.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, lidhur me hidraulikun z. Ferit Semanaj ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale eshte konstatuar mungesa e diplomes, librezes se punes si dhe CV-se.

6 -Operatori ekonomik: “ENGLAND” , me Nipti: J96829419D *me oferte ekonomike me vlere 41.973.791 (Dyzete e nje milion e nenteqind e shtatedhjetë e tre mijë e shtateqind e nentëdhjetë e nje) leke pa TVSH.*

Per arsyet

- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me mekanikun z. Nikolin Muha, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), per punonjesin ne fjale mungon. diploma, cv dhe libreze pune, dhe pas verifikimit ne listpagesat e shoqerise rezulton qe ne muajin gusht 5 dite pune, shtatorit eshte paguar me 5 dite pune, gje e cila nuk eshte ne perputhje me kushtet e kontrates se punes nenshkruar nga te dyja palet, ku citohet se punonjesi ne fjale do te punoje per 40 ore ne jave.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me elektricistin z. Luan Lleshi ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon cv dhe libreze pune.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me hidraulikun z.Rahmadan Krasniqi, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) per punonjesin ne fjale mungon cv dhe libreze pune dhe nuk figuron ne listpagesen emuajit shtator 2019, gje e cila nuk eshte ne perputhje me kushtet e kontrates se punes nenshkruar nga te dyja palet, ku citohet se punonjesi ne fjale do te punoje per 40 ore ne jave.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur me mjetin me targe AA418MA ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton se kane mbaruar afati I vlefshmerise lidhur me dokumentat e mjetit si Kontrolli i sigurimit teknik (SGS) dhe siguracioni.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit lidhur kontrate noteriale date 02.03.2015 per mjetin me targe AA925MI, ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton qe kane skaduar afati I vlefshmerise lidhur me dokumentat e mjetit si siguracioni, si dhe bazuar ne kontraten e qerese nuk eshte i cituar objekti I prokurimit sipas kriterit te pikes 2.2.7 te DST-se ku citohet: *Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerese duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.***
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit ju keni paraqitur kontrate noteriale date 20.11.2017 per mjetin me targeAA315AX, rezulton qe ne kontraten e qerese nuk eshte cilesuar objekti sic eshte kerkuar ne DST ku citohet Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerese duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti.**

- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit ju keni paraqitur kontrate noteriale date 12.01.2015 per mjetin me targeAA938CC, rezulton se ne kontraten e qerase nuk eshte cilesuar objekti sic eshte kerkuar ne DST ku citohet Makineri-pajisjet me qera te shoqerohen me kontrate qeraje si dhe me aktin e pronesise se qeradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). **Kontrata e qerase duhet te jete noteriale ku te cilesohet objekti, si dhe referuar dokumentacionit te dorezuar ne SPE lidhur me mjetin tip Fadrome me targe ADMT 04 keni paraqitur dokumentacionin perkates por nuk rezulton qe mjeti ne fjale te jete i perfshire ne shtojcen nr 10, sipas kekrkeses se AK.**
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, pas shqyrtimit te dokumentacionit te ngarkuar ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) lidhur me mjetin me targe AA761DH rezulton se mungon leja e transportit.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit, ju keni paraqitur fature tatimore nr 35 date 05.03.2010 ku lexon shprehimisht Armature m2 1200, ku ne fak ne dokumentat e tenderit pika 2.2.7 kerkohet skela metalike te kompletuara per fasade 2000 m2, ku ne baze te verifikimit te dokumentacionit tjeter ne sistem keni paraqitur fature tatimore nr 59 date 05.01.2015 me 100 m2 skele , dhe fature tatimore nr 70 date 22.06.2012 me 200 m2 skele, gje e cila ju nuk plotesoni kriterin e vendosur nga AK prej 2000 m2.
- Ne permbushje te pikes 2.2.7, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit,pas verifikimit te bera te dokumentacionit ne sistemin e prokurimeve publike elektronike per per mjetet dhe paisjet teknike rezulton qe nuk permbush kerkesat e AK si:Kamiona vetshkarkues, kamiocina, autovinc,fadrome, rimorkiator, autobetoniere dhe skela.
- Ne permbushje te pikes 2.2.6, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Veçanta te Dokumentave Standarte te Tenderit Ing Marjola Hodaj eshte e paguar me 0 (zero) dite pune ne muajin shtator 2019, gje e cila eshte ne kundersiztim me kontraten e punes qe duhet 40 ore pune ne muaj dhe kriterin e DST

7- Operatori ekonomik: “ELDA-VL” , me Nipti: K67106202W **me oferte ekonomike me vlere 0 (zero) leke pa TVSH.**

Per arsyet

- **Operatori Ekonomik ELDA-VL nuk ka paraqitur asnje dokument per permbushjen e kriterëve te DST, per proceduren ne fjale ne sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).**

8- Operatori ekonomik: “EUROGJICI-SECURITY” , me Nipti: J96829419D **me oferte ekonomike me vlere 0 (zero) leke pa TVSH**

Per arsyet

- **Operatori Ekonomik EUROGJICI-SECURITY nuk ka paraqitur asnje dokument**

per permbushjen e kriterëve të DST, për procedurën në fjalë në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE).

